

APLIKIMI PËR APROVIM TRANSPORTI/TRANZIT PËR BURIME RADIOAKTIVE

- Personi juridik/ fizik: _____
Emri, Mbiemri (përfaqësuesi ligjor) _____
Adresa _____
Adresa ku kryhet veprimtaria, nqs është e ndryshme nga më sipër _____
Tel _____
E-mail _____
Paraqit nr. e licencës së transportit _____

- Paraqit të dhënat për transportin/tranzitin e burimit radioaktiv:

Lloji i makinës dhe targa _____
Radionuklidi(et) _____
Aktiviteti total _____
Lloji i pakos. Aprovimi i paketimit _____
Emri Adresa e dërguesit _____
Emri adresa pritësit të lëndës _____
Forma kimike/fizike _____
Formën e posaçme _____
Lloji i paketimit _____
Indeksi i transportit. _____
Numri i OKB _____

- Paraqit itinerarin e lëvizjes nga pikënisja deri në destinacion

- Data ose periudha e përafërt e transportit/tranzitit _____

Dokumenta për tu ngarkuar në sistem sipas renditjes

1. Çertifikatën e cilësisë së burimit/eve radioaktiv/e
2. Çertifikatën e aprovimit të paketimit
3. Deklarata për mallrat e rrezikshëm
4. Faturën e përfitimit të burimit radioaktiv
5. Raportin e mbrojtjes nga rrezatimi gjatë transportit/tranzitit të lëndëve radioaktive në analogji me Udhëzuesin nr.72/21 datë 17/08/2021 (planin e sigurisë dhe mbrojtjes nga rrezatimi)
6. Planin e sigurimit gjatë transportit/tranzitit në përputhje me Rregulloren nr.877 datë 30/10/2015 dhe udhëzuesin nr.444/8 datë 29/03/2019.

7. Dokumentacion në lidhje me datën e prodhimit
8. Licencën e personit juridik/fizik destinacion

Ky aprovim dorëzohet origjinal në pikat doganore dhe është i vlefshme 2 javë nga data e lëshimit. Mbas transportit/tranzitit, personi Fizik/Juridik është i detyruar brenda 1 jave të njoftojë ZMR me shkrim për kryerjen e transportit/tranzitit.

Të gjithë personat juridik/fizik që bëjnë transport/tranzit të burimeve radioaktive me miratimin e aplikimit për leje transporti/tranziti kanë detyrimin ligjor për zbatimin e të gjithë kërkesave që rrjedhin nga rregullorja “Për transportin e sigurtë të materialeve radioaktive” nr.815 datë 16/11/2016, si dhe rregullores për “Sigurimin fizik të materiale radioaktive”nr.877 datë 30/10/2015

Burimet radioaktive nuk mund të transferohen tek persona juridikë e fizikë që nuk disponojnë licencën përkatëse.

Aplikuesi mban përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e të dhënave të mësipërme.

I gjithë dokumentacioni të jetë i skanuar në format pdf me ngjyra .

Aplikimi i plotësuar në mënyrë të parregullt dhe jo të plotë do të sjellë vonesa për aplikuesin për licencë. Në rast se aplikimi ka pasaktësi dhe mungesa në dokumentacion , bazuar në nenin 91/3 të Kodit të Pr. Administrative, afati për shqyrtimin e aplikimit fillon nga paraqitja e plotë e dokumentacionit.

Aprovimi për transport/tranzit të burimeve radioaktive të kategorisë 1 dhe 2 miratohet me vendim të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe është i vlefshëm për 2 javë nga data e miratimit. Afati i zbatueshëm për realizimin e shërbimit online është 60 ditë kalendarike nga paraqitja e aplikimit sipas pikës 2 të nenit 91 të Kodit të Proçedurave Administrative.

Aprovimi për transport/tranzit të burimeve radioaktive të kategorisë 3, 4 dhe 5 miratohet nga Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe është i vlefshëm për 2 javë nga data e miratimit. Afati i zbatueshëm për realizimin e shërbimit online është 10 ditë pune nga paraqitja e kërkesës për kategorinë 3 në përputhje me pikën 10/a të VKM Nr.252 datë 29.04.2022 dhe proçedurën Nr.72/4 datë 8.01.2021 “Proçedurat e aplikimit për aprovim import/eksport, transfer/tranzit të burimeve të rrezatimit jonizues si dhe vlerësimi i dokumentacionit nga ana e ZMR për këto kategori “Për kategorinë 4 afati i zbatueshëm për realizimin e shërbimit online është 5 ditë pune nga paraqitja e kërkesës dhe për kategorinë 5 afati përcaktohet 3 ditë pune nga paraqitja e kërkesës sipas parashikimit të proçedurës Nr.72/4 datë 8.01.2021.